



ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
SEKRETARIA

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më ____ .08.2020

Për mbledhjen Nr. 31, datë 10.08.2020, ora 09:00
Të Bordit të ERE-s

Në zbatim të (i) nenit 13 të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; të ndryshuar, (ii) Rregullores bazë së Organizimit dhe Funkcionimit të Entit Rregullator të Energjisë të miratuar me Vendimin e ERE-s Nr. 144/2019 dhe (iii) nenit 11 të “Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s” miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr.96, datë 16.07.2016, (iv) Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave Nr. 8, datë 24.03.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në aktin normativ nr. 3, datë 15.03.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të vecanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID – 19”, të ndryshuar, njoftojmë se **ditën e Hënë, datë 10.08.2020, ora 09:00** do të zhvillohet mbledhja nr. 31 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

- 1-** Informacion mbi kërkesën e paraqitur nga OSHEE Group sh.a., lidhur me kompesimin e energjisë elektrike bazuar në kontratën e shitblerjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a. dhe KESH sh.a. të miratuar nga ERE për vitet 2018 dhe 2019
- 2-** Mbi kërkesën e shoqërive Max Energy sh.p.k., Windsbab sh.p.k. dhe Seman Eolik sh.p.k. për rishikimin e vendimit të ERE, nr. 114, data 09.07.2020, "Mbi përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga era me fuqi të instaluar deri 3 MW per vitin 2019"
- 3-** Mbi miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në vendimin nr. 190, datë 23.11.2017, “Mbi miratimin e rregullores për përcaktimin e pagesave të rregullimit për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike”
- 4-** Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin Korrik 2020
- 5-** Mbi fillimin e procedurës për miratimin e rregullores për përcaktimin e kriterëve të vlerësimit dhe të përzgjedhjes së furnizuesit të mundësisë së fundit në sektorin e energjise elektrike
- 6-** Mbi kualifikimin e impiantit dhe pajisje me certifikatë të garancisë së origjinës për impiantin e prodhimit të energjisë elektrike “Hec Banjë”, të shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a.
- 7-** Për fillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë “Lengarica & Energy” sh.p.k, nr. 306, seria FK15, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të komisionerëve të ERE-s, nr. 105, datë 18.08.2015
- 8-** Për kërkesën e shoqërisë “Electral” sh.p.k. për zgjatjen e afatit të dorëzimit

të aplikimit për rinovimin e licencës nr. 287, seria T15, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 64, datë 11.05.2015, si dhe licencës nr. 288, seria FK15, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 65, datë 11.05.2015

9- Për plotësimin e kushtit të vendosur në pikën 3 të vendimit nr. 71, datë 22.04.2020 “Mbi licencimin e shoqërisë “Kalisi Hydropower” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec-et “Veleshica 1” me kapacitet të instaluar 5801 kW dhe “Veleshica 2”, me kapacitet të instaluar 8116 kW, me kapacitet total të instaluar 13917 kW

Në zbatim të pikës 1 të Urdhërit të kryetarit të ERE-s nr. 53, datë 11.03.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-2019”; Urdhërit nr. 53/1, datë 24.03.2020 “Për një ndryshim në urdhërin nr. 53, datë 11.03.2020”, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore” dhe Urdhërit nr. 53/2 datë 01.06.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore gjatë gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19, mbledhja nuk do të jetë e hapur për publikun.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI